



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

RELACION

**MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2023-2025**

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të Kalendarit Buxhetor të miratuar nga Këshilli Bashkiak në muajin Dhjetor 2021 me VKB nr 95 datë 28.12.2021, po ju paraqesim për miratim tavanet përgatitore të PBA 2023-2025.

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, ka nxjerrë udhëzim nr. 8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e PBA vendor 2023-2025”, i cili përmban:

- a) tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025;
- b) informacion mbi nivelin e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- c) procedurat dhe afatet e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2023-2025;
- d) mënyrën e llogaritjes së transfertave të pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- e) instrumentin e planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

**I. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm**

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, në nivel programi buxhetor.
- Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2023-2025 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 19 datë 13.01.2022, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Kuadri makroekonomik e fiskal pasqyron parashikime të treguesve ekonomikë dhe financiarë të buxhetit të qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme.
- Nëpërmjet vlerësimeve të paraqitura në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, njësia e vetëqeverisjes vendore do të analizojë burimet që do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime përbëjnë bazën për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e projektbuxhetit për periudhën 2023-2025 dhe për përcaktimin e nivelit të pagave duhet të bazohen në kuadrin ligjor të miratuar gjatë vitit 2021.
- Niveli i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2023-2025, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2021. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

**Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme**

Madhësia e transfertës së pakushtëzuar është 1.01 % e PBB-së së viteve 2023-2025 (shtojca 1 e udhëzimit). Kritelet dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2023-2025 do të jenë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Në përlllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022, kriteret e përdorura dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2023-2025 janë: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km<sup>2</sup>, numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Për Bashkinë Berat është parashikuar kjo ndarje e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme :

- o Për vitin 2023 , shuma 329,043 mijë lekë , e cila përbën 1.9 % të totalit të përgjithshëm të transfertës për 61 bashki.
- Në krahasim me vitin 2022 transferta është parashikuar me rritje +20,763 mijë lekë, ose +6.7%.
- o Për vitin 2024 , shuma 350,541 mijë lekë , e cila përbën 1.9 % të totalit të përgjithshëm të transfertës për 61 bashki .
- Në krahasim me vitin 2023 transferta është parashikuar me rritje +21,498 mijë lekë, ose +6.5%.
- o Për vitin 2025 , shuma 373,693 mijë lekë , e cila përbën 1.9% të totalit të përgjithshëm të transfertës për 61 bashki .
- Në krahasim me vitin 2024 transferta është parashikuar me rritje +23,152 mijë lekë, ose +6.6%.

Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme për bashkinë Berat për periudhën 2022-2024

në 000 lekë

<b>Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme , Bashkia BERAT	293,099	298,960	308,280	329,043	350,541	373,693
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme , TOTAL 61 BASHKITË	15,913,043	16,113,043	16,591,944	17,721,943	18,891,943	20,151,943
Pesha në transf. totale, në %	1.8%	1.9%	1.9%	1.9%	1.9%	1.9%
<b>Krahasimi me vitin paraardhës , Transf. e Bashkisë Berat</b>						
ndryshimi në vlerë	7,625	5,861	9,319	20,763	21,498	23,152
ndryshimi në %	2.7%	2.0%	3.1%	6.7%	6.5%	6.6%
<b>Krahasimi me vitin paraardhës , Transf. totale 61 Bashkitë</b>						
ndryshimi në vlerë	422,641	199,999	478,901	1,129,999	1,170,000	1,260,000
ndryshimi në %	2.7%	1.3%	3.0%	6.8%	6.6%	6.7%

**Transferta e pakushtëzuar sektoriale**

- Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

arsimin parashkollor dhe personeli jomësitor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për cdo funksion të transferuar.

- Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor në vitin 2016, për periudhën 2023-2025, bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar (shtojca nr. 3).
- Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2023-2025 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2022.

Për bashkinë e Beratit transferata e pakushtëzuar sektoriale do të jetë 275,230 mijë lekë, për secilin prej viteve 2023, 2024,2025.

në 000 lekë

<b>Transferata e pakushtëzuar sektoriale</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
<b>Total Transf. e pakushtëzuar sektoriale</b>	<b>253,962</b>	<b>258,148</b>	<b>275,230</b>	<b>275,230</b>	<b>275,230</b>	<b>275,230</b>
Konviktet e arsimit parauniversitar	27,374	27,374	27,665	27,665	27,665	27,665
Arsimi parashkollor	134,503	136,006	149,491	149,491	149,491	149,491
Arsimi parauniversitar	13,579	13,987	14,546	14,546	14,546	14,546
Mbrojtja nga zjarri	30,550	31,466	32,725	32,725	32,725	32,725
Mbrojtja sociale ( Qendra LIRA)	23,731	23,731	23,984	23,984	23,984	23,984
Administrimi i pyjeve	5,151	5,666	5,893	5,893	5,893	5,893
Rrugët rurale	4,824	4,824	5,228	5,228	5,228	5,228
Ujitja dhe Kullimi	14,250	15,095	15,699	15,699	15,699	15,699

### **Transferata e kushtëzuar**

- Transferata e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2023-2025, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

### **Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si burim financimi i funksioneve të bashkisë, për periudhën 2023-2025 parashikohen të jenë :  
për vitin 2023 parashikohen të jenë 588,231 mijë lekë, për vitin 2024 parashikohen të jenë 590,530 mijë lekë dhe për vitin 2024 parashikohen të jenë 600,731 mijë lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Të ardhurat Vendore ( taksa&tarifa vendore)

në mijë lekë

Nr	Emertimi/Muaji	Fakti 2020	Fakti 2021	Plani 2022	Plani 2023	Plani 2024	Plani 2025
<b>I</b>	<b>Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel</b>	<b>7,051</b>	<b>5,447</b>	<b>4,000</b>	<b>4,120</b>	<b>4,244</b>	<b>4,371</b>
<b>II</b>	<b>Taksa mbi te ardhurat personale</b>	<b>13,043</b>	<b>17,245</b>	<b>6,000</b>	<b>6,180</b>	<b>6,365</b>	<b>6,556</b>
<b>III</b>	<b>Taksat vendore</b>	<b>128,668</b>	<b>171,218</b>	<b>219,026</b>	<b>225,597</b>	<b>232,365</b>	<b>239,336</b>
1	Takse tabele	3,007	2,764	2,818	2,903	2,990	3,079
•	Tabelë për qëllime identifikimi	2,141	1,951	1,986	2,045	2,107	2,170
•	Tabelë për qëllime reklamimi	866	813	832	857	883	910
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	8,425	10,712	16,893	17,400	17,922	18,459
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	18,256	53,850	89,118	60,145	61,949	63,808
4	Takse fjetje ne hotel	750	1,274	2,158	2,223	2,289	2,358
5	Takse mbi token bujqesore	15,120	13,942	18,564	19,121	19,695	20,285
6	Takse e mjeteve te perdorura	30,019	33,404	29,300	30,179	31,084	32,017
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë pronësisë	4,260	3,299	3,000	3,090	3,183	3,278
8	Takse mbi ndertesat	42,299	45,328	49,807	51,301	52,840	54,425
9	Takse Trualli	6,532	6,644	7,368	7,590	7,817	8,052
10	Te tjera taksa lokale	-	-	-	-	-	-
<b>IV</b>	<b>Tarifat vendore</b>	<b>155,824</b>	<b>156,493</b>	<b>230,940</b>	<b>237,868</b>	<b>232,590</b>	<b>233,452</b>
1	Tarife e pastrimit	73,949	78,589	104,777	104,777	104,777	104,777
2	Tarife e ndriçimit publik	31,121	34,004	47,683	47,683	47,683	47,683
3	Tarife gjelberimi publik	25,584	27,976	40,250	40,250	40,250	40,250
4	Tarife Arsimi	6,743	9,339	11,135	11,135	11,135	11,135
5	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi		-		-	-	-
6	Tarifa urbanistike	9,432			-	-	-
7	Tarifa te sherbimit administrativ	40	22		-	-	-
8	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	5,949	2,938	9,523	9,808	10,102	10,405
9	Tarfia per zenie salle dhe dhenie ambjentesh me qera	-		25	26	27	27
10	Tarifa te sherbimit te varrimit	-	-	9,526	9,812	10,107	10,410
11	Tarife per lende drusore	156	10	3,100	3,193	3,289	3,387
12	Tarife uji i pijshem(Ujitje)	-	-	3,400	3,502	3,607	3,715
13	Tarife ambienti	576	690	740	762	785	809
14	Tarife therje	424	314		-	-	-
15	Te tjera tarifa		-		-	-	-
16	Tarife Ujitje						



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

		1,850	2,162		-	-	-
17	Tarife Urbanistike (kablloret)		450	780	803	828	852
<b>V</b>	<b>Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit</b>	<b>11,194</b>	<b>10,977</b>	<b>19,422</b>	<b>20,005</b>	<b>20,605</b>	<b>21,223</b>
1	Te ardhura nga konviktet	394	235	853	878	904	932
2	Te ardhura nga cerdhet	3,002	2,656	2,867	2,953	3,042	3,133
3	Te ardhura nga kopshtet	7,798	8,087	15,702	16,173	16,659	17,158
<b>VI</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>17,808</b>	<b>41,037</b>	<b>148,430</b>	<b>94,462</b>	<b>94,362</b>	<b>95,793</b>
1	Te ardhura nga parkimi	2,889	3,858	4,379	4,511	4,646	4,785
2	Te ardhura nga qerate	10,128	25,124	14,013	14,434	14,867	15,313
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	2,872			-	-	-
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	96		26,256	27,044	27,855	28,691
5	Te tjera debitore dhe gjyqe	1,617	4,009	3,000	4,705	4,510	4,510
6	Debitore Biznes + Familje	-	7,567	70,263	43,444	42,150	42,150
7	Banesat Sociale + Enti	-	-		-	-	-
<b>VII</b>	<b>Te ardhura nga MZSH</b>	<b>206</b>	<b>479</b>	<b>315</b>	<b>324</b>	<b>334</b>	<b>344</b>
<b>VIII</b>	<b>Te ardhura te pritshme nga bashkefinancimet e huaja</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>30,203</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>IX</b>	<b>Grante te huaja paplanifikuar</b>	<b>-</b>	<b>9,817</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>TOTALI 1</b>		<b>333,588</b>	<b>402,418</b>	<b>627,817</b>	<b>588,231</b>	<b>590,530</b>	<b>600,731</b>
<b>TOTALI 1 + Grantin e huaj te paplanifikuar</b>		<b>333,588</b>	<b>412,235</b>	<b>627,817</b>	<b>588,231</b>	<b>590,530</b>	<b>600,731</b>

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të mësipërm Bashkia Berat përgatiti planin financiar të periudhës afatmesme dhe tavanet përgatitore të PBA 2023-2025.

Ne perfundim parashikimi i taveve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, qe do te sherbejne per procesin e planifikimit te shpenzimeve, eshte si me poshte:

Tavanet e të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025

në mijë lekë

<b>TË ARDHURAT BUXHETORE</b>		<b>2020 F</b>	<b>2021 F</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	293,099	298,960	308,280	329,043	350,541	373,693
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	253,962	258,148	275,230	275,230	275,230	275,230
3	Transferte specifike ( mbrojtja civile)	0	8,135	0	0	0	0
4	Te ardhurat Vendore ( taksa&tarifa vendore)	528,209	500,173	512,108	588,231	590,530	600,731
4.1	<i>Te ardhura nga taksa&amp;tarifa vendore</i>	<i>528,209</i>	<i>500,173</i>	<i>481,905</i>	<i>588,231</i>	<i>590,530</i>	<i>600,731</i>
4.2	<i>Te ardhura te pritshme nga financimi i perkohshem i projekteve te huaja</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>30,203</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<b>TOTAL FONDE (1+2+3+4)</b>		<b>1,075,270</b>	<b>1,065,417</b>	<b>1,095,618</b>	<b>1,192,504</b>	<b>1,216,301</b>	<b>1,249,654</b>



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

**TAVANET PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025**

në mijë lekë

Titulli Prg	Bashkia Berat	Projekt Viti 2022 (miratuar 28.12.21)	Projekt Viti 2023		Projekt Viti 2024			Projekt Viti 2025			
			Totali	Shpenzi me Korrente	Shpenzi me Kapitale	Totali	Shpenzime Korrente	Shpenzi me Kapitale	Totali	Shpenzime Korrente	Shpenzi me Kapitale
1110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	170,195	172,833	165,133	7,700	175,496	170,087	5,409	177,291	175,189	2,102
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	13,136	13,267	13,267	0	13,533	13,533	0	13,668	13,668	0
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	86,410	56,789	56,789	0	58,493	58,493	0	59,663	59,663	0
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	19,056	17,535	17,535	0	17,885	17,885	0	18,243	18,243	0
4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	15,699	15,699	15,699	0	15,699	15,699	0	15,699	15,699	0
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	5,893	5,893	5,893	0	5,893	5,893	0	5,893	5,893	0
4520	Rrjeti rrugor rural	217,173	234,046	93,250	140,795	292,958	98,905	194,053	309,785	101,872	207,913
5100	Menaxhimi i mbetjeve	79,124	81,504	77,724	3,780	79,278	79,278	0	80,864	80,864	0
6370	Fumizimi me uje dhe Kanalizime	33,785	23,000	0	23,000	0	0	0	0	0	0
6260	Shërbimet publike vendore	96,082	91,383	90,563	820	94,130	93,280	850	96,078	96,078	0
6440	Ndricimi Publik	49,976	44,662	44,662	0	46,002	46,002	0	47,382	47,382	0
7220	Shërbimet e kujdesit parësor	0	1,512	0	1,512	0	0	0	0	0	0
8130	Sport dhe argëtim	38,570	41,945	39,281	2,664	40,852	40,352	500	41,227	41,027	200
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	49,820	30,070	29,570	500	30,957	30,457	500	31,871	31,371	500
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	203,362	217,142	205,642	11,500	214,311	211,811	2,500	219,165	218,165	1,000
9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	43,501	43,211	42,211	1,000	43,211	42,211	1,000	43,211	42,211	1,000
10430	Perkujdesja Sociale	75,719	82,368	75,178	7,190	77,014	76,714	300	78,796	78,296	500
10661	Strehimi social	13,825	19,646	7,370	12,276	10,591	7,591	3,000	10,818	7,818	3,000
<b>Totali</b>		<b>1,211,326</b>	<b>1,192,504</b>	<b>979,766</b>	<b>212,738</b>	<b>1,216,301</b>	<b>1,008,189</b>	<b>208,112</b>	<b>1,249,654</b>	<b>1,033,439</b>	<b>216,215</b>

Drejtoritë dhe ndërmarrjet e varësisë do të përgatisin kërkesat shtesë brenda muajit prill të cilat do t'i paraqiten Kryetarit të Bashkisë.

Bashkëlidhur materialit është pasqyra e planit financiar të Bashkisë Berat për PBA 2023-2025 si dhe tavanet përgatitore të PBA 2023-2025.

Drafti i parë i plotë do të paraqitet për miratim nga Këshilli Bashkiak brenda muajit Qershor 2022.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

Ju faleminderit !

Rovena Shehu  
Drejtore e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Sokol Toska  
Drejtore e Taksave dhe Tarifave

Luciano Bojaxhiu  
Drejtore e Planifikimit Urban

Erlin Kuçi  
Drejtore e Mbrojtjes Civile, Shërbimeve, Pronave dhe Transportit

Gentian Dashi  
Drejtore e Burimeve Njerëzore

Kreshnik Zaimi  
Drejtore e Policisë Bashkiake

Ervin Hoxhallari  
Drejtore e MZSH

Piro Xheblati  
Drejtore e Shërbimit Social

Arjan Shkëmbi  
Drejtore e Bujqësisë

Klodiana Hoxha  
Drejtore e Drejtorisë së Arsimit Bashkia Berat

Bledar Çili  
Drejtore e Agjencisë së Shërbimeve Publike

Arben Qafa  
Drejtore e Qendrës Kulturore “ M. Tutulani”

Alma Kule  
Drejtore e Qendrës “ Lira”



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**